



Prishtinë: 16.03.2017

Kodi i ZRRE-së: V\_902\_2017

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_1556\_02\_17**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **07.03.2017**

### në seancën e mbajtur më datë 16.03.2017, nxori këtë:

#### V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin A. F., nga Mitrovica me shifër të konsumatorit: DMI 9037879 si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK\_V\_1556\_02\_17 i datës 07.02.2017.

#### A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 07.03.2017 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë për këto shkaqe. Përfaqësuesi i KESCO-së në ankesë ka theksuar se kilovatët e faturuar në periodën e muajit 03/2014 për njehsorin me numër 08105152 ne A1=2,308 dhe A2=15,047 nuk është provuar se janë faturuar dyfish, andaj KESCO do të shqyrtoj shpërndarjen eventuale të kWh të faturuar në këtë periudhë. KESCO shton se edhe po të ishte njehsori i pasaktë në matjen e energjisë elektrike e njëjta do të bënte përmirësimin e faturimit për gjashtë muajt e fundit të këtij njehsori duke u bazuar në kodin e matjes së OSSH-së, neni 4.11.1 sipas KESCO-së DMK/ZRRE, me rastin e vendosjes se kësaj çështje ka vepruar në kundërshtim me nenin 4.11.1 të kodit të matjes së OSSH-së, pasi që ka kërkuar anulimin e faturës së muajit 03/2014. Bazuar në këtë KESCO kërkon nga Bordi që të pezullojë vendimin e DMK/ZRRE\_V\_1556\_02\_17, në lidhje me shifrën DMI 9037879.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 16.03.2017 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.



Lidhur me pretendimet e përfaqësuesit të KESCO-së, lidhur me vlerën financiare prej 1,142.04€ të faturuara nga KESCO me faturën 031462718 që sipas KESCO-së, si faturim i mbështetur në dispozita ligjore të përcaktuara me nenin 4.11.1 të Kodit të Matjes së OSSH-së, për Bordin pretendimet të tilla janë vlerësuar si të paqëndrueshme për faktin se vlera e faturuar në pikën matëse të konsumatorit nuk është dëshmuar si shpenzim real i konsumatorit por që regjistrim i shpenzimeve si pasojë e njehsorit elektrik që ka qenë i vendosur në këtë pikë matëse.

Për më tepër këtë fakt e vërteton më së miri deklarata e punëtorëve të autorizuar të KEDS në procesin e lëshuar me numër 1073089 të datës 03.03.2014, ku theksohet: ***“konsumatori është lexuar rregullisht, tarifa e dytë e njehsorit elektrik për njëherë ka kërcyer, gjithashtu është theksuar se ky njehsor të mos faturohet të dërgohet në kalibrim urgjentisht”.***

Bordi gjithashtu ka identifikuar shkeljet e bëra nga ana e përfaqësuesve të KESCO/KEDS pasi që edhe përkundër rekomandimit të ekipit inspektues të KEDS për shqyrtimin e njehsorit në laboratorin e kalibrimit dhe obligimit ligjor që kanë për shqyrtim në raste të tilla të njëjtit përkundër kësaj kanë bërë shkatërrimin e njehsorit elektrik në mënyrë të kundërligjshme me qëllim që të pamundësohet identifikimi i gjendjes teknike të njehsorit elektrik.

Bordi i ZRRE-së gjithashtu ka konstatuar se nuk qëndrojnë pretendimet e KESCO-së se edhe po të ishte njehsori i pasaktë në matjen e energjisë elektrike, KESCO do të bënte përmirësimin e faturës për gjashtë muajt e fundit, për faktin se nga analizat e bëra të rrjedhës së energjisë elektrike pika matëse e konsumatorit shpenzimin e energjisë elektrike e ka vetëm në periudhën e verës kur konsumatori vjen për pushime në Kosovë për shkak se i njëjti jeton në shtetin Gjerman, andaj është i paqëndrueshëm arsyetimi i KESCO-së se edhe po të kishte çrregullime njehsori në do të veprojmë njësoj kur dihet se për atë periudhë konsumatori nuk ka pasur fare shpenzim të energjisë elektrike andaj si të ngarkohet i njëjti me një vlerë të tillë.

Sipas nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji theksohet: *“konsumatorët kanë obligimin që të paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifën për shfrytëzim të sistemit të miratuar nga ZRRE-ja”.* Bazuar në këtë dispozitë ligjore është konstatuar se në rastin konkret konsumatori ka pasur obligim që të paguaj për atë që ka shpenzuar, por që jo të ngarkohet pa bazë për rastet që kanë probleme teknike në njehsorin elektrik.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 16.03.2017 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

---

Krenar Bujupi, u.d. kryesues

---

Arsim Janova, anëtar

---

Besim Sejfiqaj, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit A. F. dhe,
- Arkivit të ZRRE-së.